



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE

УСТАВНИ СУД

CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 22 janar 2015

Nr. ref.RK755/15

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI138/14

Parashtrues

Majda Fazli-Neziri

Kërkesë për dhënien e mendimit të Gjykatës lidhur me mundësinë e punësimit me titullin e fituar akademik master

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruese e kërkesës është znj. Majda Fazli-Neziri, fshati Lubizhdë, komuna e Prizrenit.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës nuk i konteston vendimet e autoriteteve publike, por vetëm kërkon mendimin e Gjykatës lidhur me titullin e fituar akademik dhe mundësinë e punësimit.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes ka të bëjë me mendimin këshillëdhënës të Gjykatës, lidhur me mundësinë e punësimit në shkollën fillore me titullin e fituar akademik master.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, nen 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 15 shtator 2014, parashtruesja e kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).
6. Më 7 tetor 2014, Kryetari i Gjykatës me Vendimin nr. GJR. KI138/14, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI138/14, caktoi Kolegjin shqyrtyues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 10 tetor 2014, Gjykata njoftoi parashtruesen e kërkesës për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 8 dhjetor 2014, Kolegji shqyrtyues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përbledhja e faktave

9. Parashtruesja e kërkesës, parashtriroi në Gjykatë kërkesën prej një gjysmë faqe në të cilën thotë „... se ajo është studente e studimeve master, Departamenti i Historisë në Fakultetin Filozofik të Prishtinës, se ajo është studente e mirë dhe se pas fitimit të titullit master dëshiron të punojë si profesorëshë e historisë në gjuhën bosnjake në shkollën fillore“.
10. Sidoqoftë, në një datë të pacaktuar, në një bisedë joformale me stafin e Drejtoratit për arsim në Prizren, i është thënë se me titullin e fituar master, ajo nuk mund të punojë në shkollën fillore si arsimtare e rregullt e lëndës së historisë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

11. Parashtruesja në kërkesën e saj ka theksuar se i ka dhënë të gjitha provimet me notë mesatare, dhe momentalisht është duke punuar në tezën e masterit.
12. Parashtruesja e kërkesës i drejtohet Gjykatës me kërkesën si në vijim:

„Lus Gjykatën Kushtetuese që të deklarohet, të jap mendimin, kur të diplomoj MASTER-HISTORI, pranë Universitetit të Prishtinës-Departamenti Histori, a mund të punoj si profesor i historisë në shkollën fillore“.

Pranueshmëria e kërkesës

13. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtrueses, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesja e kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

14. Sa i përket kërkesës konkrete të parashtrueses, Gjykata i referohet rregullit 36, parografi 3, pika f) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

„Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur: f) kërkesa nuk është ratione materiae në pajtim me Kushtetutën“.

15. Gjykata është e obliguar të shqyrtojë nëse ka juridikSION *ratione materiae* në çdo fazë të procedurës. Përputhshmëria me Kushtetutën dhe instrumentet ndërkombëtare, të cilat janë pjesë përbërëse të Kushtetutës në pajtim me nenin 53 të Kushtetutës *ratione materiae* e ndonjë kërkesë, buron nga kompetenca thelbësore e Gjykatës. Në mënyrë që një kërkesë të jetë në pajtim *ratione materiae* me Kushtetutën, e drejta në të cilën thirret parashtruesja, duhet të jetë e mbrojtur me Kushtetutë.
16. Pasi që parashtruesja para Gjykatës ka ngritur çështjen e cila nuk është në përputhje me pikën 113.7 të Kushtetutës, del se kërkesa nuk është *ratione materiae* në pajtim me dispozitat e Kushtetutës, dhe si e tillë është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 36 (3) f) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 8 dhjetor 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari rapportues

Ivan Čukalović



Kryetari i Gjykatës Kushtetueses

Prof. dr. Enver Hasani

